



Pranimi / Imprimuar Printed / Printed	13 - 05	2022	2	viti god year
Organ / Dësia Organ / Dësia	Pr. Prof. Pr. Prof.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSHK	27.97/2022		114	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.320/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.320/2022 të datës 04.04.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër

Thesarit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 13.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.320/2022 e datës 04.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Republikës së Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të vendimit, duke bërë kompensimin e në një shumë monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil për ankuesin me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes-babait.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 24.02.2022 ka nxjerr Vendim Ref.02/Nr.51 me të cilin ka bërë ndarjen e mjeteve financiare

të një page mesatare në shërbimin civil për ankuesin me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (babait). Ministria së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Thesarin e Republikës së Kosovës, ka proceduar kërkesën për pagesë retroaktive të datës 10.03.2022, për kompensimin e mjeteve financiare me rastin e vdekjes së babait të ankuesit në vlerën 374 Euro, mirëpo në muajin mars nuk është bërë kompensimi.

Ankuesi më datë 30.03.2022 ka kërkuar nga Thesari i Republikës së Kosovës arsyetim lidhur me këtë mos kompensim, ndërsa të njëjtën ditë është njoftuar që i mungon deklarata e bashkësisë familjare për mos procedimin e kërkesës, ndërsa në të njëjtën ditë pas kërkesës, ankuesi është njoftuar nga Zëvendësudhëyesi i Përgjithshëm-Administratë dhe TI, ka njoftuar ankuesin që mos procedimi nuk nënkupton që kërkesa është refuzuar mirëpo është udhëzuar që të dërgohet dokumentacioni me të cilat dëshmohet që ka jetuar në bashkësi familjare me prindin duke e udhëzuar për gjetjen e një zgjedhje qoftë edhe me akt noterial nën betim.

Ankuesi, më datë 04.04.2022 fizikisht ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:1796/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet që t'i bëhet kompensimi me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.320/2022 të datës 04.04.2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për pagesë retroaktive e datës 10.03.2022; Vendimin Ref.02/Nr.51 i datës 24.02.2022 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Certifikatë e lindjes Nr. L 24502661 e datës 22.02.2022; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile Nr. E 259334464 i datës 23.02.2022; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile Nr. E 25916984 i datës 15.02.2022; Certifikatë e vdekjes Nr V 10480117 e datës 15.02.2022; Liste e pagave mars 2022; Email i date 30.03.2022 nga ankues për Email i datës 30.03.2022 nga për ankuesin; Emailin e datës 30.03.2022 nga për ankuesin; Emailin e datës 30.03.2022 nga ankuesi për Emailin e datës 30.03.2022 nga për ankuesin; Emailin e datës 30.03.2022 nga për ankuesin; Deklaratën LRP-Nr.Rend.6452/2022 e datës 29.04.2022 nga Noteri.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar së ankesa e ankuesit është e bazuar, **SEPSE:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon që në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të obligohet Thesari i Republikës së Kosovës, t'i bëhet kompensimi në rastin e vdekjes së babait të tij.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku përcaktohet se: 2. *Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim; ...2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësit civil; si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku parashihet se: ...2. Sipas Nenit*

22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, në rast të vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, dhe ka konstatuar që me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, nëpunësi civil gëzon të drejtën e ndihmës institucionale, përmes realizimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

Se kush përbënë familjen, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i'u referua Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht nenit 271 ku përcaktohet se: *"Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji"*. Lidhur me këtë, Kolegji sjell në vëmendje Aktgjykimin A.A.nr.14/2017, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është konfirmuar përkufizimi i familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes.

Mbi këtë bazë, si dhe bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Deklaratës LRP-Nr.Rend.6452/2022 të lëshuar nga Noteri e të cilën ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka dorëzuar më datë 29.04.2022, atëherë sipas kësaj deklarata ku ankuesi ka deklaruar që: *"Me përgjegjësi time të plotë morale, penale dhe materiale deklaron se unë deklaroem-dhënësi me shënime si më lartë jetoj në shtëpinë e babës tim të ndjer*

..", bazuar në këtë deklaratë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson që sipas nenit 3 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë, përcaktohet që: *"Vërtetësia dhe zbatueshmëria e dokumenteve të noterizuara bazohet në nënshkrimin, formën dhe përmbajtjen e dokumentit. Dokumentet e noterizuara gëzojnë supozimin e dyfishtë të ligjshmërisë. Ato mund të kontestohen vetëm përmes procedurave gjyqësore"*. Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji vlerëson se ankuesi me deklaratën e tij noteriale, ka dëshmuar që ka jetuar në bashkësi familjare më babain e tij deri në momentin e vdekjes, kështu që duke i'u referuar nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, për rastin e vdekjes së babait është i bazuar, andaj Thesari i Republikës së Kosovës, duke i marr parasysh këto fakte si dhe duke i'u referuar këtij vendimi dhe dispozitave të lartcekura, është e obliguar që ankuesit t'i bëjë kompensimin e shpenzimeve për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes-babait, në një shumë monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.320/2022, datë 13.05.2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Republikës së Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

